

**“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti**

**Pasqyrat financiare**

**Me dhe për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2017**

**TPA Albania shpk**

Rr.Reshit Collaku, Pall.Shallvare, Apt.44, 1000 Tirana, Albania

[www.tpa-group.com](http://www.tpa-group.com)

Albania | Austria | Bulgaria | Croatia | Czech Republic | Hungary | Poland | Romania | Serbia | Slovakia | Slovenia

## **PËRMBAJTJA**

## **FAQE**

### **RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR**

#### **PASQYRAT FINANCIARE:**

<b>Pasqyra e pozicionit financiar</b>	<b>5</b>
<b>Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave gjithëpërfshirëse</b>	<b>6</b>
<b>Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto</b>	<b>7</b>
<b>Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare</b>	<b>8</b>
<b>Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare</b>	<b>9–29</b>

#### **TPA Albania shpk**

Rr.Reshit Collaku, Pall.Shallvare, Apt.44, 1000 Tirana, Albania

[www.tpa-group.com](http://www.tpa-group.com)

Albania | Austria | Bulgaria | Croatia | Czech Republic | Hungary | Poland | Romania | Serbia | Slovakia | Slovenia



# Raporti i Audituesit të Pavarur

---

Për Drejtimin e Unifin Shoqëri Kursim Krediti,

## Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Unifin Shoqëri Kursim Krediti (më poshtë “Shoqëria” ose “Unifin SHKK”) që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2017, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare për periudhën e mbyllur në këtë datë, si edhe një përmbledhje të politikave kontabël dhe shënimeve të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Unifin SHKK paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017, performancën e saj financiare dhe flukset e mjeteve monetare për periudhën e mbyllur dhe ndryshimet në kapital në atë datë, në përputhje me ligjin shqiptar “Mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e shoqërive të kursim kreditit dhe të unioneve të tyre”.

## Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Entiteti në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit Ndërkombëtar për Standardet e Etikës (Kodi i IESBA) dhe Kodit të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (Kodi i IEKA), së bashku me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të amenduar, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

TPA Albania shpk

Rr.Reshit Collaku, Pall.Shallvare, Apt.44, 1000 Tirana, Albania

[www.tpa-group.com](http://www.tpa-group.com)

Albania | Austria | Bulgaria | Croatia | Czech Republic | Hungary | Poland | Romania | Serbia | Slovakia | Slovenia

## **Njohja e të ardhurave nga interesi mbi baza te arkëtimit**

Ne tërheqim vëmendje ne lidhje me njohjen e të ardhurave nga interesi i kredive. Sic shprehet edhe në shënimin 3(k) të pasqyrave financiare, të ardhurat nga interesi i kredisë njihen atëherë kur arkëtohen dhe jo në bazë rritëse atëherë kur përfitohen. Në bazë të rregullores së Bankës së Shqipërisë “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e shoqërive të kursim kreditit dhe të unioneve të tyre” SHHK-të ekistuese përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, duhet të marrin masa që interesin nga kreditë ta kontabilizojnë mbi baza rritëse brenda datës 30 Qershor 2021.

## **Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen Për Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me ligjin shqiptar “Mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e shoqërive të kursim kreditit dhe të unioneve të tyre”, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, per shënimet shpjeguese për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveç sa më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

## **Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

**TPA Albania shpk**

Rr.Reshit Collaku, Pall.Shallvare, Apt.44, 1000 Tirana, Albania


[www.tpa-group.com](http://www.tpa-group.com)

Albania | Austria | Bulgaria | Croatia | Czech Republic | Hungary | Poland | Romania | Serbia | Slovakia | Slovenia

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së entitetit për vijësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar me qeverisjen, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Datë 20 Qershor 2018

  
 Laura Gjinali EKR Nr. Lic 351



**TPA Albania shpk**

Rr.Reshit Collaku, Pall.Shallvare, Apt.44, 1000 Tirana, Albania

[www.tpa-group.com](http://www.tpa-group.com)


Albania | Austria | Bulgaria | Croatia | Czech Republic | Hungary | Poland | Romania | Serbia | Slovakia | Slovenia

**“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti****31 Dhjetor 2017****Pasqyra e pozicionit financiar***(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)*

	Shënime	31 Dhjetor 2017	1 Gusht 2017
<b>Aktivët</b>			
Mjetet monetare	5	280,945,968	275,390,080
Bono thesari	6	39,317,464	-
Kredi të dhëna anëtarëve (neto)	7	713,682,946	701,589,663
Aktive afatgjata materiale	8	14,092,642	12,113,799
Aktive afatgjata jo materiale	9	1,490,394	1,559,394
Të tjera të arkëtueshme	10	7,970,192	7,968,215
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>1,057,499,606</b>	<b>998,621,151</b>
<b>Detyrimet</b>			
Depozita nga anëtarët	11	814,704,366	750,568,853
Detyrime të tjera	12	23,222,469	22,993,589
		<b>837,926,835</b>	<b>773,562,442</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali	13	85,238,871	87,667,121
Rezerva		34,760,984	34,760,984
Teprica/(deficit) i mbartur		99,572,916	102,630,604
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>219,572,771</b>	<b>225,058,709</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>1,057,499,606</b>	<b>998,621,151</b>

*Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese 1 – 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.*

Pasqyrat financiare të Unifin SHKK për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017 u aprovuan nga Drejtimi i SHKK-se, më 15 Qershor 2018 dhe janë firmosur nga:

  
Zj. Elvana Sharkaj  
Administratore



  
Zj. Elda Poppa  
Drejtore Finance

**“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti**  
**31 Dhjetor 2017**  
**Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve**

*(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)*

	Shënime	Per priudhën prej formimit deri me 31 Dhjetor 2017
Të ardhura nga interesi	14	40,854,134
Shpenzime interesi	15	(10,945,502)
<b>Të ardhura neto nga interesi</b>		<b>29,908,632</b>
Shpenzimi i provizionit		(5,641,227)
<b>Të ardhura neto pas zhvlerësimit të huave</b>		<b>24,267,405</b>
Të ardhura nga kthimi i kredive të fshira		2,039,016
Të ardhura të tjera		235,559
<b>Të ardhura jo nga interesi</b>		<b>2,274,575</b>
Shpenzime personeli	16	(18,439,960)
Shpenzime administrative	17	(10,315,359)
Zhvlerësimi dhe Amortizimi	8, 9	(1,001,142)
Fitim (humbje) neto nga këmbimi valutor		156,793
<b>Totali i shpenzimeve operative</b>		<b>(29,599,668)</b>
<b>Rezultati i vitit</b>		<b>(3,057,688)</b>

*Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet 1 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.*

**“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti**

**31 Dhjetor 2017**

**Pasqyra e ndryshimeve në kapital**

*(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)*

	<b>Kapitali</b>	<b>Rezervat</b>	<b>Teprica/(Deficiti) i mbartur</b>	<b>Totali</b>
<i>Gjendja më 1 Gusht 2017</i>	<b>87,667,121</b>	<b>34,760,984</b>	<b>102,630,604</b>	<b>225,058,709</b>
Rritje/(reduktim) i kapitalit	(2,428,250)	-	-	<b>(2,428,250)</b>
Rezultati i vitit	-	-	(3,057,688)	<b>(3,057,688)</b>
<i>Gjendja më 31 dhjetor 2017</i>	<b>85,238,871</b>	<b>34,760,984</b>	<b>99,572,916</b>	<b>219,572,771</b>

*Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet 1 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.*

**“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti****31 Dhjetor 2017****Pasqyra e flukseve monetare***(Të gjitha shumat janë në LEK)*

	<b>Për periudhën prej formimit deri më 31 Dhjetor 2017</b>
<i>Flukse monetare nga aktiviteti operacional</i>	
<b>Rezultati i vitit</b>	(3,057,688)
<i>Rregullime për rakordimin e rezultatit neto me aktivitetet e shfrytëzimit:</i>	
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	1,001,142
Shpenzimi i privizionit	5,641,227
Të ardhura nga interesi	(40,854,134)
Shpenzime interesi	10,945,502
<b>Fluksi neto nga aktiviteti i shfrytëzimit para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operacionale</b>	<b>(26,323,951)</b>
<i>Ndryshimet e aktiveve dhe detyrimeve të shfrytëzimit:</i>	
(Rritje)/ rënie në tëpricën e aktiveve të tjera	229,420
(Rritje)/ rënie e kredisë	(17,734,510)
Rritje/ (rënie) e depozitave të anëtarëve	64,135,513
Rritje/ (rënie) e detyrimeve të tjera	228,880
<b>Flukset neto nga aktiviteti operacional</b>	<b>20,535,352</b>
Interesi i arkëtuar	40,854,134
Interesi i paguar	(16,998,868)
	<b>44,390,618</b>
<b>Flukset e parasë nga aktivitetet investuese</b>	
Investime në bono thesari	(39,317,464)
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	2,910,985
<b>Flukset monetare neto nga aktivitetet investuese</b>	<b>(36,406,480)</b>
<i>Flukse monetare nga veprimtaritë financuese:</i>	
Rritje/ (rënie) e kapitalit	(2,428,250)
<b>Fluksi monetar neto i përdorur në veprimtaritë financuese</b>	<b>(2,428,250)</b>
<b>(Rënie)/ rritje neto e mjeteve monetare</b>	<b>5,555,888</b>
<b>Mjete monetare në fillim të periudhës</b>	<b>275,390,080</b>
<b>Mjete monetare në fund të periudhës</b>	<b>280,945,968</b>

*Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet 1 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.*

**1. Informacion i përgjithshëm**

Unifin Shoqëri Kursim Krediti (“Unifin SHKK” ose “Organizata”) është një Shoqëri Kursim Krediti e cila zhvillon veprimtarinë e saj në bazë të ligjit Nr. 52 “Për shoqëritë e kursim kreditit dhe unionet e tyre”. Unifin SHKK është krijuar si rezultat i bashkimit me përthithje të Unionit të Shoqërive të Kursim Kreditit “Jehona” dhe Shoqërise së Kursim Kreditit “Neëcred”.

Në 3 Dhjetor 2016 u mbajt Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë së Kursim Kreditit “NeëCred” dhe Asambleja e Përgjithsme e Unionit të SHKK-ve “Jehona” ku u mor vendimi për shndërrimin e Unionit të SHKK-ve “Jehona” në një SHKK të vetme, bazuar në procesin e njohur dhe të lejuar nga nenet 55 e vijues të ligjit 52/2016. Në bazë të këtij vendimi dhe nenit 55 të ligjit Nr. 52 “Për Shoqëritë e Kursim Kreditit” Unioni i Shoqërive të Kursim Kreditit “Jehona” dhe SHKK-ja ekzistuese “NeëCred” do të shndërrohen pa likuidim në një SHKK të vetme të quajtur “Unifin” SHKK.

Vendimi për bashkimin e Unionit të SHKK-ve “Jehona” dhe të SHKK Neëcred është aprovuar nga Banka e Shqipërisë sipas shkresës Nr. Prot. 6605 datë 14.04.2016.

Unifin SHKKu licensua nga Banka e shqipërise për të vepruar si Shoqëri Kursim Krediti në dat 14 Korrik 2017.

Anëtarët e Shoqërisë së kursim kreditit janë individë, persona fizikë ose juridikë, të cilët depozitojnë kursimet e tyre dhe marrin hua nëpërmjet shoqërisë dhe që pranojnë aktet nënligjore të miratuara nga Shoqëritë e Kursim-Kreditit.

Objekti i veprimtarisë është kryerja e funksioneve financiare kryesisht sigurimi i fermerëve me mikrokredi që përdoren për nevojat e fermerëve për mbjellje gjatë sezonit bujqësor për shtim dhe rritje të numrit të krerëve, për zgjerimin e serave dhe investimeve të nryshme në periudha të ndryshme të vitit.

Unifin SHKK udhëhiqet dhe mbikqyret nga Bordi Drejtues si dhe Komiteti Mbikqyrës të cilët përbëhen si më poshtë:

**Bordi drejtues:**

Z. Ruzhdi Koni  
Z. Ëngjell Jazxhi  
Z. Arben Qafëzezi  
Zj. Vojsava Prozaj  
Z. Vlاديمi Caci  
Zj. Suela Coka  
Z. Sabri Skënderi  
Zj. Jolanda Trebicka  
Zj. Mimoza Hamza

**Komiteti i Mbikqyrës:**

Zj. Merita Cela  
Zj. Suela Coka  
Zj. Mimoza Breçani

Zyrat qendrore të Unifin SHKK janë në Rrugen Dervish Hima, Pallati Nr. 8, apartamenti Nr. 5, Tiranë.

**“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti**  
**31 Dhjetor 2017**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)*

Bilanci e Unionit të Shoqërive të Kursim Kreditit Jehona më datë 31 Korrik 2017 përpara procesit të përthithjes dhe pas procesit të përthithjes, nën emrin Unifin SHKK, ishte si më poshtë.

	<b>31 Korrik 2017</b>	<b>31 Korrik 2017</b> <b>Pas përthithjes</b>
<b>Aktivet</b>		
Mjetet monetare	11,162,358	275,390,080
Depozita me afat dhe bono thesari	-	-
Kredi të dhëna anëtarëve (neto)	34,822,999	701,589,663
Aktive afatgjata materiale	6,842,815	13,673,193
Aktive të tjera	45,261,230	7,968,215
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>98,089,402</b>	<b>998,621,151</b>
<b>Detyrimet</b>		
Depozita nga anëtarët	31,588,191	750,568,853
Detyrime të tjera	252,442	22,993,589
	<b>31,840,633</b>	<b>773,562,442</b>
<b>Kapitali aksionar dhe rezervat</b>		
Kapitali aksionar	161,761,681	87,667,121
Rezerva ligjore	8,853,371	34,760,984
Teprica/(deficit) i mbartur	(104,366,284)	102,630,604
<b>Totali i kapitalit</b>	<b>66,248,769</b>	<b>225,058,709</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>	<b>98,089,402</b>	<b>998,621,151</b>

**“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti**  
**31 Dhjetor 2017**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)*

-Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve e Unionit të Shoqërive të Kursim Kreditit Jehona më datë 31 Korrik 2017 përpara procesit të përthithjes dhe pas procesit të përthithjes, nën emrin Unifin SHKK, ishte si më poshtë.

	<b>1 Janar deri me 31 Korrik 2017</b>	<b>1 Janar deri me 31 Korrik 2017 Pas përthithjes</b>
Të ardhura nga interesi	1,919,254	64,028,453
Shpenzime interesi	(609,254)	(17,422,138)
<b>Të ardhura neto nga interesi</b>	<b>1,310,000</b>	<b>46,606,315</b>
Shpenzimi i provigjonit	336,910	(3,172,310)
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>1,646,910</b>	<b>43,434,005</b>
Të ardhura nga kthimi i kredive të fshira	-	3,614,591
Të ardhura të tjera	10,372,516	736,131
<b>Të ardhura jo nga interesi</b>	<b>10,372,516</b>	<b>4,350,722</b>
Shpenzime administrative	(4,292,415)	(17,592,795)
Shpenzime personeli	(7,742,582)	(16,276,407)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	(371,389)	(687,349)
Fitim (humbje) neto nga këmbimi valutor	118,303	121,222
<b>Totali i shpenzimeve operative</b>	<b>(12,288,084)</b>	<b>(34,435,329)</b>
<b>Rezultati i vitit</b>	<b>(268,658)</b>	<b>13,349,398</b>

## **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave**

### **2.1 Bazat e përgatitjes**

Pasqyrat financiare të Unifin SHKK janë përgatitur në bazë të ligjit për “Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe rregullores së Bankës së Shqipërisë” “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e shoqërive të kursim kreditit dhe unioneve të tyre”.

### **2.2 Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### **2.3 Monedha funksionale dhe raportuese**

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale për Unifin SHKK.

Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen me kursin zyrtar të këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare të mbajtura në monedhë të huaj konvertohen sërish me kursin zyrtar të datës së bilancit. Të gjitha diferencat regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

## **2.4 Parimi i vijimësisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijueshmërisë dhe nuk përfshijnë ndonjë korigjim që mund të rezultojë nga kjo çështje.

## **3. Përmbledhje e politikave kontabël**

### **(a) Mjetet monetare**

Mjetet monetare përfshijnë gjendjet e arkës dhe llogaritë bankare rrjedhëse me maturim deri në tre muaj.

### **(b) Instrumentet financiare**

Instrumentet financiare njihen fillimisht me kosto, e cila është vlera e drejtë e shumës së dhënë, që përfshin komisionet e blerjes në lidhje me instrumentin financiar. Fitimet dhe humbjet e realizuara dhe të porealizuara, përfshihen në të ardhurat neto.

### **(c) Letrat me vlerë të investimit të mbajtura për maturim**

Unifin SHKK i klasifikon investimet e veta si “të mbajtura deri në maturim”. Drejtimi përcakton klasifikimin e investimeve në njohjen fillestare.

Letrat me vlerë, të cilat kanë pagesa fikse apo të përcaktueshme, synohen të mbahen deri në maturim. Ato përfaqësojnë bonot e thesarit dhe bonot qeveritare të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë pas regjistrimit fillestar, letrat me vlerë të mbajtura për maturim mbahen me kosto të amortizuar, minus provizionet për zhvlerësime në vlerë. Amortizimi vjetor i zbritjeve apo i primeve për blerjen e letrave me vlerë të mbajtura për maturim i bashkohet të ardhurave të tjera nga investimi gjatë afatit të instrumentit në mënyrë që të ardhurat e njohura në cdo periudhë të përfaqësojnë të ardhura konstante nga letrat me vlerë.

### **(d) Aktivet financiare të vlefshme për shitje**

Ky klasifikim përfshin letrat me vlerë të investimeve të cilat Unifin SHKK ka ndërmend ti mbajë për një periudhë të pacaktuar kohe dhe të cilat mund të shiten në përgjigje të nevojave për likuiditet, ose për shkak të ndryshimeve në normat e interesit, normat e këmbimit apo çmimet e kapitalit. Letrat me vlerë të vlefshme për shitje mbahen me vlerën e drejtë. Të ardhurat nga interesi për letrat me vlerë të vlefshme për shitje llogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe njihen në fitimin ose humbjen e vitit korent. Dividentët mbi instrumentat e kapitalit neto të vlefshme për shitje njihen në fitim ose humbje për vitin kur e drejta e Shoqërisë për të marrë pagesën është njohur dhe është e mundur që dividentët do të mblidhen. Të gjithë elementët e tjerë të ndryshimeve në vlerën e drejtë njihen në të tjera të ardhura gjithëpërfshirëse deri sa investimi cregjistrohet ose zhvlerësohet, kohë në të cilën fitimi ose humbja kumulative është riklasifikuar nga të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse në fitim ose humbje për vitin.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje për vitin kur ndodhin si rezultat i një apo më shumë ngjarjeve (“ngjarje humbjesh”) që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të letrave me vlerë të investimeve të vlefshme për shitje. Një rënie të konsiderueshme ose e zgjatur në vlerën e drejtë të një instrumenti të kapitalit nën koston e tij është një tregues se ajo është zhvlerësuar. Humbja kumulative nga cvlerësimi, e matur si diferenca midis koston së blerjes dhe vlerës së drejtë aktuale, minus cdo humbje nga vzhvlerësimi mbi atë aset njohur më parë në fitim ose humbje, është riklasifikuar nga të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse në fitim ose humbje për vitin. Humbjet nga zhvlerësimi për instrumenta të kapitalit nuk janë të kthyeshëm dhe të gjitha fitimet pasuese njihen në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Në qoftë se në një periudhë të mevonshme, vlera e drejtë e një instrumenti të borxhit i klasifikuar si i vlefshëm për shitje rritet dhe rritja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje

**“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti**  
**31 Dhjetor 2017**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)*

që ka ndodhur pasi humbja nga zhvlerësimi është njohur ne fitim ose humbje, humbja nga zhvlerësimi anulohet nëpërmjet fitimit ose humbjes për vitin.

**(e) Kreditë**

Kreditë u jepen anëtarëve të Unifin SHKK si një formë e drejtpërdrejtë financimi dhe mbahen me kosto të amortizuara. Të gjitha kreditë njihen kur mjetet monetare i transferohen anëtarëve.

Kreditë mbahen duke i zbritur provizionin për rënie në vlerë të kredive. Provizioni për rënie në vlerë përcaktohet nëse ka të dhëna objektive që Unifin SHKK nuk do të mund të mbledhë shumat përkatëse.

Kur një kredi është e pambledhshme, ajo çregjistrohet kundrejt provigjionit përkatës për rënien në vlerë. Rimarrjet e mëpasshme kreditohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Provizionet krijohen në bazë të vendimit Nr. 105 të bankës së Shqipërisë për miratimin e rregullores “Për administrimin e riskut në veprimtarinë e Shoqërive të kursim kreditit dhe unioneve të tyre” të aprovuar nga Këshilli i Mbikqyrjes më 5 Tetor 2016.

Unifin ka aplikuar përqindjet minimale në vijim për secilën kategori risku të përcaktuar në rregulloren e administrimit të rrezikut, në lidhje me kreditë e dhëna ndaj anëtarëve:

<b>Kategoria e kredisë</b>	<b>Normat e provigjionimit</b>
Standarde (0-30 ditëvonesë)	2%
Në ndjekje (31-90 ditëvonesë)	15%
Nën standarde (91-180 ditëvonesë)	40%
Të dyshimta (181-365 ditëvonesë)	75%
Të humbura (mbi 365 ditëvonesë)	100%

**(f) Aktive afatgjata materiale**

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar i cili llogaritet mbi vlerën e mbetur përgjatë jetëve të dobishme të aktiveve. Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivitetit.

Një shpenzim i mëvonshëm kapitalizohet vetëm kur është e mundur që në të ardhmen përfitimet ekonomike nga shpenzimi do të përfitohen nga Shoqëria. Riparimet dhe mirëmbajtja e vazhdueshme njihen si shpenzime kur ato ndodhin.

Aktivitet afatgjata amortizohen me 10% mbi vlerën e mbetur.

Përmirësimet e ambienteve të marra me qira lidhen me shpenzime për rinovim zyresh dhe regjistrohen si aktive të tjera. Këto aktive amortizohen përgjatë periudhës së qirasë.

**(g) Aktivitet afatgjata jo-materiale**

Aktivitet afatgjata jo-materiale përfshijnë licencat për programe të blera nga Shoqëria dhe maten me koston historike të zvogëluar me amortizimin.

Aktivitet afatgjata jo materiale amortizohen me normen 10 % mbi vlerën e mbetur.

**(h) Huamarrje**

Huamarrjet njihen fillimisht me vlerë të drejtë duke i zbritur koston e transaksioneve. Huamarrjet maten më pas me kosto të amortizuar, çdo diferencë midis arkëtimeve minus kostot e transaksionit dhe vlerës së ripagesës njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përgjatë afatit të huamarrjes duke përdorur metodën e interesit efektiv.

**(i) Qiratë**

Qiratë në të cilat pjesa më e rëndësishme e rreziqeve dhe përfitimeve nga pronësia i mbahen nga qiradhënësi klasifikohen si qira operative (të zakonshme). Totali i pagesave të kryera në saj të qirave njihen si shpenzimoperativ në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në mënyrë lineare përgjatë periudhës së qirasë.

**(j) Kapitali**

Kapitali i Unifin SHKK përbëhet nga kapitali i paguar (kontribute), rezervat e krijuara dhe fitimet e mbartura ose humbjet dhe donacionet. Kapitali i paguar përbëhet nga kontributet e kryera nga anëtarët e SHKK-së në saj të anëtarësimit të tyre. Vlera nominale e kontributeve mund të ndryshojë me vendim të asamblesë.

**(k) Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat nga interesi i kredive njihen kur interesi arkëtohet. Të ardhurat nga interesi i investimeve financiare dhe shpenzimet e interesit njihen në bazë rritëse kur të ardhurat përfitohen dhe kur shpenzimet kryhen.

**(l) Perfitimet e punonjësve**

Unifin SHKK përdor një skemë me kontribute të përcaktuara për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore e cila është ajo publike e detyruar. Unifin SHKK paguan kontributet në skemën e administruar nga shteti e cila është e detyrueshme. Unifin SHKK nuk ka asnjë detyrim të mëtejshëm për të paguar pasi kontributet janë derdhur. Kontributet njihen si shpënzime për punonjësit kur lind detyrimi për to.

**(m) Tatimi mbi të ardhurat**

Unifin SHKK në bazë të ligjit nr. 52 të vitit 2016 “Për soqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre” është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin. Unifin SHKK është vetëm subjekt i ligjit për tatimin mbi të ardhurat personale dhe ligjit për sigurimet shoqërore dhe kontributet shëndetësore.

**4. Administrimi i riskut financiar**

Aktivitetet e Unifin SHKK janë nga natyra e tyre kryesisht të lidhur me instrumentet financiare. Një instrument financiar është një kontratë që krijon një të drejtë për të marrë mjete monetare ose një aktiv tjetër për njërën palë (aktiv financiar) ose detyrim për të dhënë mjete monetare ose një aktiv tjetër një pale tjetër (detyrim financiar). Instrumentet financiare rezultojnë në disa rreziqe për Unifin SHKK. Rreziqet më të rëndësishme me të cilat përballet Unifin SHKK janë: risku i kredisë, risku i likuiditeti dhe risku i tregut.

Risku i tregut përfshin riskun e kurseve të këmbimit (riskun valutor), riskun e normës së interesit dhe rreziqe të tjera të çmimit.

Huamarrësit e Unifin SHKK mund të ndikohen negativisht nga ambjenti financiar dhe ekonomik, të cilët mund të ndikojnë në aftësinë e tyre për të shlyer shumat e borxhit. Përkeqësimi i kushteve ekonomike për huamarrësit mund të ketë një ndikim në rrjedhën e parashikimeve të manaxhimit për paratë të gatshme dhe vlerësimin e rënies së vlerës së mjeteve financiare dhe jo-financiare.

**(i) Risku kreditor**

**“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti**  
**31 Dhjetor 2017**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)*

Ekziston një rrezik kredie në momentin që palët nuk arrijnë të përmbushin detyrimet e tyre lidhur me pagesat e detyrimeve që kanë ndaj Unifin SHKK.

Unifin SHKK është subjekt i riskut kreditor nëpërmjet aktiveve të kredi-dhënies ndaj anëtarëve. Unifin SHKK manaxhon riskun kreditor duke lidhur marrëveshje vetëm me anëtarët dhe duke kryer një analizë të detajuar të riskut kreditor për çdo aplikim disbursimi dhe duke investuar likuiditetet e veta në banka tregtare vendase ose instrumente financiare të Qeverisë Shqiptare. Unifin SHKK monitoron rregullisht limitet dhe ekspozimet e veta kundrejt palëve individuale dhe anëtarëve.

Ekspozimi maksimal ndaj riskut kreditor përpara çdo provigjoni është paraqitur më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>1 Gusht 2017</b>
Mjetet monetare	280,945,968	275,390,080
Bono thesari	39,317,464	-
Kredi të dhëna anëtarëve	713,682,946	701,589,663
Aktive të tjera	7,970,192	7,968,215
	<b>1,041,916,570</b>	<b>984,947,958</b>

	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>1 Gusht 2017</b>
Kredi të dhëna anëtarëve		
Standarde (0 - 30 Ditë)	717,083,547	701,702,215
Në ndjekje (31 - 90 Ditë)	5,470,566	8,342,096
Nënstandarte (91 - 180 Ditë)	7,321,461	6,651,483
Të dyshimta (181 - 365 Ditë)	10,691,590	13,310,064
Të humbura (Mbi 365 Ditë)	23,793,673	16,620,469
<b>Kredite bruto</b>	<b>764,360,837</b>	<b>746,626,327</b>
Minus zbritje provizioni	(50,677,891)	(45,036,664)
<b>Kreditë neto</b>	<b>713,682,946</b>	<b>701,589,663</b>

**(ii) Risku i likuiditetit**

Risku i likuiditetit është risku që Unifin SHKK do të hasë vështirësi në grumbullimin e fondeve për të përmbushur angazhimet që lidhen me instrumentet financiare, dhe në përgjithësi për të ruajtur vazhdimësinë e veprimtarisë kryesore të bizneseve të tij (operationet e kreditit, shërbimet depozituese dhe pagesave). Mbi një bazë operative, Unifin SHKK monitoron stabilitetin e depozitave të saj, dhe mbi këtë bazë rregullohen gjendjet e aktiveve afatshkurtra/ qasjen në fonde në mënyrë që të ruajë aftësinë e lartë paguese.

Tabela në vijim jep analizën e aktiveve dhe detyrimeve të Unifin SHKK sipas grupimeve të maturitetit duke u bazuar në periudhën e mbetur të ripagesës më 31 dhjetor 2017.

**“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti**  
**31 Dhjetor 2017**

**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)*

**31 Dhjetor 2017**

	<b>1 muaj</b>	<b>1 - 3 muaj</b>	<b>3 – 12 muaj</b>	<b>Mbi 1 vit</b>	<b>Totali</b>
<b>Aktiv</b>					
Mjete monetare	280,945,968	-	-	-	<b>280,945,968</b>
Bono thesari	-	-	39,317,464	-	<b>39,317,464</b>
Kredi dhënë anëtarëve	12,202,542	10,530,053	98,495,955	592,454,396	<b>713,682,946</b>
Aktive të tjera	7,970,192	-	-	-	<b>7,970,192</b>
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>301,118,702</b>	<b>10,530,053</b>	<b>137,813,419</b>	<b>592,454,396</b>	<b>1,041,916,570</b>
<b>Detyrime</b>					
Depozita nga anëtarët	147,008,015	87,815,801	525,494,705	54,385,845	<b>814,704,366</b>
Detyrime të tjera	4,148,263	-	-	19,074,206	<b>23,222,469</b>
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>151,156,278</b>	<b>87,815,801</b>	<b>525,494,705</b>	<b>73,460,051</b>	<b>837,926,835</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>149,962,424</b>	<b>(77,285,748)</b>	<b>(387,681,286)</b>	<b>518,994,345</b>	<b>203,989,735</b>

**“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti**  
**31 Dhjetor 2017**

**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)*

Tabela në vijim jep analizën e aktiveve dhe detyrimeve të Unifin SHKK sipas grupimeve të maturitetit duke u bazuar në periudhën e mbetur të ripagesës më 1 gusht 2017.

**1 Gusht 2017**

	<b>1 muaj</b>	<b>1 - 3 muaj</b>	<b>3 – 12 muaj</b>	<b>Mbi 1 vit</b>	<b>Totali</b>
<b>Aktivi</b>					
Mjete monetare	275,390,080	-	-	-	<b>275,390,080</b>
Bono thesari	-	-	-	-	-
Kredi dhënë anëtarëve	2,231,010	9,120,768	130,569,096	559,668,789	<b>701,589,663</b>
Aktive të tjera	7,968,215	-	-	-	<b>7,968,215</b>
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>285,589,305</b>	<b>9,120,768</b>	<b>130,569,096</b>	<b>559,668,789</b>	<b>984,947,958</b>
<b>Detyrime</b>					
Depozita nga anëtarët	170,152,366	122,702,543	361,501,292	96,212,652	<b>750,568,853</b>
Detyrime të tjera	22,993,589	-	-	-	<b>22,993,589</b>
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>193,145,955</b>	<b>122,702,543</b>	<b>361,501,292</b>	<b>96,212,652</b>	<b>773,562,442</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>92,443,350</b>	<b>(113,581,775)</b>	<b>(230,932,196)</b>	<b>463,456,137</b>	<b>211,385,516</b>

**(iii) Risku i tregut**

*Risku i normës së interesit*

Operacionet e Unifin SHKK janë subjekt i riskut të luhatjeve të normës së interesit në masën që aktivet dhe detyrimet që fitojnë/ mbartin interes maturohen apo interesi i tyre ricmohet në kohë apo në sasi të ndryshme. Unifin SHKK përpiqet të zvogëlojë këtë risk duke monitoruar datat e ricimit të aktiveve dhe detyrimeve të veta.

Përveç kësaj efekti aktual dotë varet nga një numër faktorësh të tjerë, duke përfshirë edhe masën deri në të cilën pagesat janë bërë më herët apo më vonë sesa datat e kontraktuara dhe variacionet në ndjeshmërinë e normës së interesit brenda periudhave të ricimit dhe për cdo valutë.

**“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti**  
**31 Dhjetor 2017**

**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)*

**31 Dhjetor 2017**

<b>Aktivi</b>	<b>Deri 6 muaj</b>	<b>6 - 12 muaj</b>	<b>Mbi 1 vit</b>	<b>Nuk mbartin interes</b>	<b>Totali</b>
Mjete monetare	280,945,968	-	-	-	280,945,968
Bono thesari	-	39,317,464	-	-	39,317,464
Kredi dhënë anëtarëve	37,616,259	83,612,291	592,454,396	-	713,682,946
Aktive të tjera	-	-	-	7,970,192	7,970,192
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>318,562,227</b>	<b>122,929,755</b>	<b>592,454,396</b>	<b>7,970,192</b>	<b>1,041,916,570</b>
<b>Detyrime</b>					
Depozita nga anëtarët	346,394,620	413,923,901	54,385,845	-	814,704,366
Detyrime të tjera	-	-	-	23,222,469	23,222,469
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>346,394,620</b>	<b>413,923,901</b>	<b>54,385,845</b>	<b>23,222,469</b>	<b>837,926,835</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>(27,832,393)</b>	<b>(290,994,146)</b>	<b>538,068,551</b>	<b>(15,252,277)</b>	<b>203,989,735</b>

**1 Gusht 2017**

<b>Aktivi</b>	<b>Deri 6 muaj</b>	<b>6 - 12 muaj</b>	<b>Mbi 1 vit</b>	<b>Nuk mbartin interes</b>	<b>Totali</b>
Mjete monetare	275,390,080	-	-	-	275,390,080
Bono thesari	-	-	-	-	-
Kredi dhënë anëtarëve	50,789,842	91,131,032	559,668,789	-	701,589,663
Aktive të tjera	-	-	-	7,968,215	7,968,215
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>326,179,922</b>	<b>91,131,032</b>	<b>559,668,789</b>	<b>7,968,215</b>	<b>984,947,958</b>
<b>Detyrime</b>					
Depozita nga anëtarët	421,970,388	232,385,813	96,212,652	-	750,568,853
Detyrime të tjera	-	-	-	22,993,589	22,993,589
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>421,970,388</b>	<b>232,385,813</b>	<b>96,212,652</b>	<b>22,993,589</b>	<b>773,562,442</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>(95,790,466)</b>	<b>(141,254,781)</b>	<b>463,456,137</b>	<b>(15,025,374)</b>	<b>211,385,516</b>

**“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti**  
**31 Dhjetor 2017**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)*

*Risku valutor*

Unifin SHKK është i ekspozuar ndaj riskut të valutës nëpërmjet transaksioneve në monedhë të huaj. Risku valutor është risku që vlera e instrumentave financiare do të luhetet për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit.

Ekspozimet e transaksioneve të Unifin SHKK sjellin fitime dhe humbje nga valutat e huaja të cilat njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Këto ekspozime përbëhen nga aktive dhe detyrime monetare dhe Jo-monetare të Unifin SHKK të cilat nuk janë të mbajtura në monedhën funksionale.

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj riskut të kursit të këmbimit në 31 dhjetor 2017 dhe 2016 ishte si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017		
	LEK	EUR	USD
Mjetet monetare	248,512,322	29,991,263	2,442,384
Bono thesari	39,317,464	-	-
Kredi të dhëna anëtarëve	705,299,785	8,383,161	-
Aktive të tjera	7,970,192	-	-
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>1,001,099,762</b>	<b>38,374,424</b>	<b>2,442,384</b>
Depozita nga anëtarët	770,562,909	40,590,034	3,551,423
Detyrime të tjera	23,222,469	-	-
<b>Totali detyrimeve</b>	<b>793,785,379</b>	<b>40,590,034</b>	<b>3,551,423</b>
<b>Ekspozimi neto më 31 Dhjetor</b>	<b>207,314,384</b>	<b>(2,215,610)</b>	<b>(1,109,039)</b>

	1 Gusht 2017		
	LEK	EUR	USD
Mjetet monetare	250,612,894	22,513,557	2,263,630
Bono thesari	-	-	-
Kredi të dhëna anëtarëve	694,126,688	7,462,975	-
Aktive të tjera	7,968,215	-	-
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>952,707,797</b>	<b>29,976,531</b>	<b>2,263,630</b>
Depozita nga anëtarët	716,290,759	30,897,371	3,380,723
Detyrime të tjera	22,993,589	-	-
<b>Totali detyrimeve</b>	<b>739,284,348</b>	<b>30,897,371</b>	<b>3,380,723</b>
<b>Ekspozimi neto më 31 Dhjetor</b>	<b>213,423,450</b>	<b>(920,840)</b>	<b>(1,117,093)</b>

Kursi i këmbimit të Lek-ut në përfundim të periudhës raportuese ishte si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	1 Gusht 2017
<b>1 USD</b>	111.17	113.39
<b>1 EUR</b>	132.95	132.98

Forcimi ose dobësimi i monedhës Lek me 10% kundrejt monedhës EUR më 31 dhjetor 2017 do të sillte rritje ose ulje në kapital dhe rezultat në shumën 221,561 Lek (1 gusht 2017: 92,084).

Forcimi ose dobësimi i monedhës Lek me 10% kundrejt monedhës USD më 31 dhjetor 2017 do të sillte rritje ose ulje në kapital dhe rezultat në shumën 110,904 Lek (1 gusht 2017: 111,709).

**“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti**  
**31 Dhjetor 2017**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)*

**(iv) Menaxhimi i kapitalit**

Rregullorja për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e shoqërive të kursim kreditit kërkon një shumë minimale të kapitalit për të mbuluar ekspozimin ndaj rrezikut dhe atij të tregut. Tabela e mëposhtme paraqet kërkesat e rregullores si dhe përqindjet e Unifin SHKK në datën e bilancit.

	<b>31 Dhjetor 2017</b>
Totali i zërave të ponderuara me rrezikun	771,814,257
Totali i zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezikun	-
<b>Totali i aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezikun</b>	<b>771,814,257</b>
Kapitali i SHKK-ve	219,572,77
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (4/3)*100	28
Në dy vitet e para të veprimtarisë	jo më pak se 10%
Në vitet në vazhdim	jo më pak se 12%
Kapitali / Totali i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara neto	jo më pak se 100% 1,409
Kapitali / Totali i kredive me probleme (neto) të pa garantuara me cash	jo më pak se 100% 3,434

**5. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre**

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2017 dhe 1 gusht 2017 janë përbërë si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>1 Gusht 2017</b>
Mjete monetare në arkë	3,749,611	4,393,754
Llogari rrjedhëse në banka	129,670,213	170,499,583
Depozita në banka vendase	147,526,144	100,496,743
<b>Totali</b>	<b>280,945,968</b>	<b>275,390,080</b>

Depozitat ne mjetet monetare perfshijnë depozita me afat te mbetur maturimi me te vogel se tre muaj nga data e raportimit.

**6. Bono thesari**

Bonot e thesarit më 31 dhjetor 2017 dhe 1 gusht 2017 janë përbërë si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>1 Gusht 2017</b>
Bono thesari	39,317,464	-
<b>Totali</b>	<b>39,317,464</b>	-

**“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti**  
**31 Dhjetor 2017**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)*

**7. Kredi të dhëna anëtarëve**

Kreditë përbëhen si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>1 Gusht 2017</b>
Kredi të dhëna anëtarëve (bruto)	764,360,837	746,626,327
Fond provizioni	<u>(50,677,891)</u>	<u>(45,036,664)</u>
	<b><u>713,682,946</u></b>	<b><u>701,589,663</u></b>

Kreditë e dhëna anëtarëve në Lekë mbartin interesa nga 4.5% deri në 17% dhe kanë maturitet deri në 8 vite. Kreditë në Euro mbartin interes nga 10% deri në 13% dhe kanë maturitet deri në 5 vite.

Unifin ka aplikuar përqindjet minimale në vijim për secilën kategori risku të përcaktuar në rregulloren e mbikqyrjes, në lidhje me kreditë e dhëna ndaj anëtarëve.

	<b>Normat e provizionimit</b>
Standarde (0 - 30 Ditë)	2%
Në ndjekje (31 - 90 Ditë)	15%
Nënstandarde (91 - 180 Ditë)	40%
Të dyshimta (181 - 365 Ditë)	75%
Të humbura (Mbi 365 Ditë)	<u>100%</u>

Lëvizja në fondin e provizionit për huatë dhënë anëtarëve paraqitet si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2017</b>
Më 1 gusht	(45,036,664)
Rimarrje provizioni nga kreditë e fshira	2,039,016
Fondi i provizionit për vitin	<u>(7,680,244)</u>
<b>Më 31 Dhjetor</b>	<b><u>(50,677,892)</u></b>

**“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti**  
**31 Dhjetor 2017**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)*

**8. Aktive afatgjata materiale**

Aktivitet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2017 dhe 1 gusht 2017 janë përberë si më poshtë:

	<b>Mjete transporti</b>	<b>Inventare ekonomike</b>	<b>Totali</b>
<b>Kosto</b>			
<b>Gjendja më 1 Gusht 2017</b>	1,105,849	11,566,142	<b>12,671,990</b>
Shtesa	-	2,910,985	<b>2,910,985</b>
Nxjerrje jashtë përdorimi	-	(354,050)	<b>(354,050)</b>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>1,105,849</b>	<b>14,123,076</b>	<b>15,228,924</b>
<b>Zhvlerësimi i akumuluar</b>			
<b>Gjendja më 1 Gusht 2017</b>	64,508	493,683	<b>558,191</b>
Zhvlerësimi i vitit	46,067	886,074	<b>932,141</b>
Nxjerrje jashtë përdorimi	-	(354,050)	<b>(354,050)</b>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>110,575</b>	<b>1,025,707</b>	<b>1,136,282</b>
<b>Vlera kontabël neto</b>			
<b>Më 1 Gusht 2017</b>	<b>1,041,341</b>	<b>11,072,459</b>	<b>12,113,799</b>
<b>Më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>995,274</b>	<b>13,097,369</b>	<b>14,092,642</b>

**9. Aktive afatgjata jo materiale**

Aktivitet afatgjata jo materiale më 31 dhjetor 2017 dhe 1 gusht 2017 janë përberë si më poshtë:

	<b>Programe</b>	<b>Totali</b>
<b>Kosto</b>		
<b>Gjendja më 1 Gusht 2017</b>	1,655,993	<b>1,655,993</b>
Shtesa	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimi	-	-
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>1,655,993</b>	<b>1,655,993</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>		
<b>Gjendja më 1 Gusht 2017</b>	96,599	<b>96,599</b>
Amortizimi i vitit	69,000	<b>69,000</b>
Nxjerrje jashtë përdorimi	-	-
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>165,599</b>	<b>165,599</b>
<b>Vlera kontabël neto</b>		
<b>Më 1 Gusht 2017</b>	<b>1,559,394</b>	<b>1,559,394</b>
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>1,490,394</b>	<b>1,490,394</b>

**“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti**  
**31 Dhjetor 2017**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)*

**10. Të tjera të arkëtueshme**

Aktive të tjera më 31 dhjetor 2017 dhe 1 gusht 2017 përbëhen si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>1 Gusht 2017</b>
Debitorë të tjerë	231,397	-
Interesa të përlllogaritura të depozitave	1,061,597	-
Parapagime	6,677,198	7,968,215
	<u><b>7,970,192</b></u>	<u><b>7,968,215</b></u>

**11. Depozita nga anëtarët**

Depozitat nga anëtarët më 31 dhjetor 2017 dhe 1 gusht 2017 përbëhen si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>1 Gusht 2017</b>
Depozita pa afat	55,197,004	52,630,776
Depozita me afat	648,811,574	591,220,177
Depozita te bllokuara	91,992,516	87,724,467
Interesa te perlllogaritura	18,703,272	18,993,433
	<u><b>814,704,366</b></u>	<u><b>750,568,853</b></u>

**12. Detyrime të tjera**

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2017 dhe 1 gusht 2017 përbëhen si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>1 Gusht 2017</b>
Fonde rezerve	19,074,206	18,399,045
Detyrime tatimore	2,166,796	1,191,578
Detyrime te tjera	1,171,082	885,454
Detyrime ndaj furnitoreve	810,385	2,091,821
Detyrime ndaj punonjësve	-	425,691
	<u><b>23,222,469</b></u>	<u><b>22,993,589</b></u>

**13. Kapitali**

Kapitali i Unifin SHKK përbëhet si vijon:

	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>1 Gusht 2017</b>
Kapitali i paguar	18,435,052	20,863,302
Fondet të donatorëve	66,803,819	66,803,819
	<u><b>85,238,871</b></u>	<u><b>87,667,121</b></u>

**“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti**  
**31 Dhjetor 2017**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)*

**14. Të ardhura nga interesat**

Të ardhurat nga interesat të Unifin SHKK analizohen si më poshtë.

	<b>31 Dhjetor 2017</b>
Të ardhura nga interesi i kredive	40,292,909
Të ardhura nga interesi i depozitave dhe bonove	532,059
Të ardhura nga interesi i llogarive rrjedhëse	29,166
	<hr/>
	<b>40,854,134</b>
	<hr/> <hr/>

**15. Shpenzime interesi**

Shpenzimet e interesit përbehen nga interesat e krijuara nga depozitat me afat të vendosura nga anëtarët. Depozitat me afat mbajnë iteresa nga 1% deri në 7.5%.

**16. Shpenzime personeli**

Kostoja e punës përbëhet nga pagat dhe kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të cilat analizohen si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2017</b>
Pagat bruto	14,663,335
Kontributet e sigurimeve shoqërore	1,722,917
Honorare	2,053,708
	<hr/>
	<b>18,439,960</b>
	<hr/> <hr/>

**17. Shpenzime administrative**

Shpenzimet administrative analizohen si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2017</b>
Qira	2,382,026
Shpenzime zyre	1,726,673
Shpenzime konsulence	1,014,762
Shpenzime për sigurimin e depozitave	791,227
Transport, dieta etj.	726,478
Shpenzime për sigurimin e jetës se debitorit	657,660
Publicitet, rreklama	656,944
Komunikim	530,341
Shpenzime të tjera administrative	494,885
Shpenzime për bordin drejtues	305,970
Energji, ujë, etj.	279,588
Shpenzime për pritje e përfaqësime	221,810
Sherbime bankare	200,506
Taksa dhe tarifa vendore	177,529
Trajnime	148,960
	<hr/>
	<b>10,315,359</b>
	<hr/> <hr/>

**“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti**  
**31 Dhjetor 2017**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)*

**18. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara**

Përgjatë rrjedhës normale të aktivitetit të tij, Unifin SHKK përballet me padi të ndryshme ligjore. Drejtimi i Unifin SHKK është i mendimit se nuk do të ketë humbje të rëndësishme nga paditë ligjore në proces më 31 dhjetor 2017.

**19. Ngjarje pas datës së raportimit.**

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së raportimit që do të kërkonte rregullime apo shpjegime të mëtejshme për pasqyrat financiare të Unifin SHKK.

**20. Palët e lidhura**

Një përmbledhje e balancave dhe transaksioneve me palët e lidhura është si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>1 Gusht 2017</b>
<b>Aktive</b>		
Kredi dhënë anëtarëve	713,682,946	701,589,663
<b>Detyrime</b>		
Depozita nga anëtarët	814,704,366	750,568,853
<b>Të ardhura gjatë periudhës</b>		
Të ardhura interesi	40,854,134	-
<b>Shpenzime të periudhës</b>		
Shpenzime interesi	10,945,502	-